

Në Hajvali gjenden mbetje
mortore që dyshohet
të jenë të personave
të zhdukur në luftë

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

QEVERIA NË PIKEPYETJE: AFATI AFROHET, SHENJA NUK KA

FAQE 4

Negociatat e Vetëvendosjes me partitë e tjera për formimin e qeverisë mbeten të paqarta dhe pa rezultate konkrete. Marrëveshja e kandidatit të LDK-së në Vushtrri me Vetëvendosjen shkaktoi reagime të forta nga qendra e partisë. Afati për prezantimin e qeverisë skadon më 26 tetor, ndërsa ankesa e Listës Serbe në Kushtetuese mund ta vështirësojë më tej procesin

AKTUALE



**PËRFUNDON NUMËRIMI I VOTAVE
NGA JASHTË KOSOVËS** F.3

**OVLUÇ DËNON VENDIMIN E
SPECIALES PËR REFUZIMIN E
PROVAVE PËR KRIMET SERBE:
FYERJE PËR DREJTËSINË** F.5

**PRESIDENTJA OSMANI ORGANIZON
DARKËN E LAMËS** F.7

EKONOMI



**DELEGACIONI I BQK-së PËRFUNDON
ME SUKSES TAKIMET VJETORE
2025 TË FMN-SË DHE BB-së** F.8

**PENSIONISTËT MBI 80 VJEÇ DHE
ATA ME PROBLEME SHËNDËTËSORE
MUND TË LAJMËROHEN NGA
SHTËPIA** F.8

SPORT



**KOMBËTARJA E KOSOVËS
GRUMBULLOHET PËR DY NDESHJET
E "PLAY-OFF"-it NDAJ TUROISË,
OBJEKTIV KTHIMI NË LIGËN B** F.11



**GJYKATA SPECIALE I REFUZON
DËSHMITË E KRIMEVE SERBE NË
KOSOVË: JANË TË PARËNDËSISHME
PËR RASTIN E KRERËVE TË UÇK-së** F.2

**KURTI PËR FORMIMIN E
QEVERISË: NUK ËSHTË
KOLLAJ POR, SIÇ DUKET,
PRAPË ALTERNATIVË
JANË ZGJEDHJET** F.5



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Sanae Takaichi, gruaja e parë kryeministre në Japoni

TOKIO, 21 TETOR - Konservatorja e linjës së ashpër, Sanae Takaichi, është zgjedhur gruaja e parë kryeministre e Japonisë, e cila pritet ta drejtojë shtetin kah e djathta. Ish-ndihmëse e kryeministrit Shinzo Abe dhe admiruese e ish-kryeministres britanike,

Margaret Thatcher, Takaichi i ka siguruar 237 vota në Dhomën e Ulët të Parlamentit, nga 465 sa janë gjithsej. Fitorja e saj shënon një moment të rëndësishëm për vendin në të cilin kanë udhëhequr gjithmonë burrat. Ajo pritet të ketë qasje më të ashpër në

temat sikurse imigrimi dhe çështjet sociale. Japonia është duke u përballur me rritje të çmimeve, situatë që e ka rritur zemërimin publik dhe e ka rritur mbështetjen për grupet e së djathtës. Ndonëse ka fituar mjaftueshëm vota për pozitën e

kryeministres, asaj do t'i duhet mbështetje më e madhe e partive opozitare për të udhëhequr në mënyrë efektive. Takaichi pritet ta bëjë betimin në mbrëmjen e së martës. Emërimi i saj ka ardhur pasi kryeministri në shkuarje Shigeru Ishiba ka dhënë



dorëheqje një muaj më parë, duke e marrë përgjegjësinë për humbjen e partisë së tij në zgjedhje.

EVROPA THOTË SE VIJAT E TANISHME TË FRONTIT NË UKRAINË DUHET TË JENË PIKËNISJA E BISEDIMEVE PËR PAQE

BRUKSEL, 21 TETOR - Udhëheqësit evropianë kanë thënë të martën se vijat e tanishme të frontit në Ukrainë duhet të jenë pikënisja për çfarëdo bisedimesh për paqe. Kërkesa e tyre vjen teksa përgatitjet për një takim në mes të presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, dhe atij të Rusisë, Vladimir Putin, duket se kanë hasur në pengesa. Trumpi - i cili javën e kaluar foli në telefon me Putinin dhe u takua me presidentin e Ukrainës, Volodymyr Zelensky - ka thënë se synon ta takojë liderin rus në kryeqytetin e Hungarisë, Budapest, brenda dy javësh, si pjesë e përpjekjeve për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë. Por, përgatitjet për takimin mes tyre duket se janë pezulluar, pasi një takim paraprak mes sekretarit amerikan të Shtetit, Marco Rubio, dhe ministrit të Jashtëm rus, Sergei Lavrov, është shtyrë. Ky takim pritej të mbahej në

Budapest të enjten. Lavrovi dhe Rubio folën në telefon të hënën. Zëvendësi i Lavrovit, Sergei Ryabkov, tha të martën se është ende herët për të folur për kohën e ndonjë takimi ballë për ballë mes tyre.

Evropianët duan që Trumpi të sigurojë lëshime këtë herë

Ministri i Jashtëm i Hungarisë, Peter Szijjarto, ishte të martën në Uashington, ku shkroi në Facebook: "Na presin disa ditë shumë serioze përpara". Aleatët evropianë të Ukrainës kanë shprehur shqetësim se Trumpi mund të takohet për herë të dytë me Putinin pa siguruar ndonjë lëshim të rëndësishëm nga lideri rus. Putini nuk e kishte pranuar thirrjen e Trumpit për armëpushim kur ky i fundit e priti në Alaskë në gusht. Në një deklaratë të martën,



udhëheqësit e fuqive kryesore evropiane, përfshirë Britaninë, Francën, Gjermaninë dhe BE-në, thanë se "mbështetja fuqishme qëndrimin e presidentit Trump se luftimet duhet të ndalen menjëherë dhe se vija e tanishme e kontaktit duhet të jetë pika fillestare e negociatave". Ukraina dhe aleatët e saj evropianë prej kohësh kanë kërkuar

armëpushim të menjëhershëm përgjatë vijave të tanishme të frontit para fillimit të bisedimeve për paqe - një qëndrim që Trumpi e mbështeti publikisht të premten e kaluar pas takimit me Zelenskyn në Shtëpinë e Bardhë. Moska ka thënë se dëshiron që Ukraina t'i dorëzojë asaj më shumë tokë si pjesë e disa kushteve që Rusia ka vënë për

arritjen e armëpushimit. Reutersi dhe medie të tjera raportuan se takimi i Trumpit me Zelenskyn me dyer të mbyllura javën e kaluar ka qenë i tensionuar dhe se presidenti amerikan kishte përdorur herë pas here fjalor të ashpër dhe e i kishte bërë trysni Zelenskyt t'i pranonte disa prej kërkesave të Rusisë. Megjithatë, Zelensky e ka paraqitur takimin si sukses, pasi ai përfundoi me mbështetjen publike të Trumpit për armëpushim në vijat e tanishme të frontit - që është qëndrim i kahershëm i Kievit. Udhëheqësit evropianë pritet të takohen këtë javë me Zelenskyn si mysafir i tyre, fillimisht në një samit të BE-së dhe më pas në një takim të "koalicionit të vullnetit" të vendeve që po diskutojnë krijimin e një force sigurie për të garantuar një marrëveshje pas luftës në Ukrainë. Rusia e kundërshton një forcë të tillë ndërkombëtare.

ISH-PRESIDENTI FRANCEZ SARKOZY NIS DËNIMIN ME BURGIM

PARIS, 21 TETOR - Nicolas Sarkozy është kthyer në ish-presidentin e parë të Francës që përfundon në burg. Dënimi i tij me burgim pesëvjeçar ka nisur të martën, pasi është shpallur fajtor se ka komplotuar për ta financuar fushatën e tij zgjedhore me paratë e ish-diktatorit të Libisë, Muammar Gaddafi. Hera e fundit që i ka ndodhur diçka e ngjashme Francës ka qenë viti



1945, kur ishte burgosur lideri kolaboracionist nazist Philippe

Pétain me akuzat për tradhti gjatë Luftës së Dytë Botërore. Sarkozy, i cili ka qenë president në periudhën 2007-2012, do të qëndrojë në burgun La Sante në një qeli prej 9 metrash katrorë. Më shumë se 100 persona janë parë duke qëndruar para burgut, pasi djali i tij, Louis, 28-vjeçar, u ka bërë thirrje mbështetësve që të tregojnë përkrahje. Sarkozy është deklaruar

vazhdimisht i pafajshëm për akuzat që rëndojnë mbi të. Ndonëse ai ka thënë se nuk dëshiron trajtim special në burgun La Sante, autoritetet e kanë ndarë atë në një qeli të veçantë për çështje të sigurisë. Brenda qelisë, ish-presidenti do të ketë banjën, zonën për dush dhe një televizor të vogël. Përgjatë ditës atij do t'i lejohen ushtrime brenda një ore në ambiente të jashtme.

"Nuk jam i frikësuar nga burgjet. Do ta mbaj kokën lart edhe në ambientet e burgut", ka thënë ai në hyrje të ndërtesës së burgut. Mes të tjerash, ai ka thënë se do t'i marrë me vete dy libra, njërin për jetën e Krishtit dhe tjetrin për Kontin e Monte Kristos, e cila ka të bëjë me jetën e një burri të burgosur gabimisht, i cili arratiset për t'u hakmarrë ndaj prokurorëve të tij.

Kryediplomatja e BE-së: Ukraina nuk duhet të heqë dorë nga territori në këmbim të paqes me Rusinë

BRUKSEL, 21 TETOR - Kaja Kallas, përfaqësuesja e lartë e BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, ka thënë se Ukraina nuk duhet të heqë dorë nga territoret e saj si pjesë e ndonjë marrëveshje paqeje me Rusinë. Duke folur me gazetarët në Luksemburg pas një takimi të ministrave të Jashtëm të BE-së, Kallas e bëri të qartë qëndrimin

e saj mbi papranueshmërinë e tregtisë me territoret ukrainase. "Nëse thjesht i japim territoret, atëherë kjo u jep një mesazh të gjithëve se mund të përdorni forcë kundër fqinjëve tuaj dhe të merrni atë që dëshironi. Mendoj se kjo është shumë e rrezikshme. Kjo është arsyeja pse kemi ligjin ndërkombëtar në vend, [në mënyrë] që askush

të mos e bëjë këtë", shtoi Kallas. Gjatë një takimi të premten e kaluar, Steve Witkoff, i dërguari special i presidentit të ShBA-së, Donald Trump, sugjeroi që presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky duhet të heqë dorë nga Donbasi si pjesë e një marrëveshjeje armëpushimi. Vetë Trumpi tha në një intervistë me "Fox News" të dielën se

Rusia do të mbante një pjesë të territorit që pushtoi gjatë luftës. Sipas një burimi të "Politico", udhëheqësit e BE-së shprehën mbështetjen e tyre për Zelenskyn pas takimit në Shtëpinë e Bardhë. Ndërkohë, udhëheqësit evropianë ishin të kujdesshëm në deklaratat e tyre, nëse Ukraina duhet ta mbajë të gjithë territorin e saj sipas një



marrëveshjeje të mundshme paqeje.

KURTI PËR FORMIMIN E QEVERISË: NUK ËSHTË KOLLAJ POR, SIÇ DUKET, PRAPË ALTERNATIVË JANË ZGJEDHJET



LONDËR, 21 TETOR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, gjatë një tubimi me diasporën shqiptare në Londër ka folur hapur për krijimin e qeverisë së re. I mandatuar nga presidentja e Kosovës për formimin e qeverisë Kurti 3, ai ka thënë se po përpiket maksimalisht deri të dielën ta formojë qeverinë e re, por e pranon se nuk do ta ketë kollaj. Kurti ka përmendur zgjedhjet si alternativë, në rast se nuk bëhet qeveria e re, pasi thotë se opozita nuk po duket që ka vullnet e synim për ta bërë qeverinë e re. “Do të përpiqemi maksimalisht që deri në dielën më së largu, të hënën nuk mund të përgatitemi. Sepse të

hënën ose do ta bëjmë qeverinë ose nuk do ta bëjmë (qesh). Prandaj në këto ditët e mbetura jemi duke komunikuar, jemi duke biseduar. Nuk është kollaj. S’di qysh t’jua shpjegoj. Ndoshta e keni dëgjuar edhe ju vetë. Është intoksuar atmosfera shumë, ka shumë xhelozë e inati e cinizëm shumë më shumë se ide, punë e pasion. Por, jemi ku jemi këtu dhe do të përpiqemi ta bëjmë qeverinë. Por, siç duket, alternativa është se do të shkojmë në zgjedhje prapë. Ose do ta bëjmë qeverinë, ose shkojmë në zgjedhje prapë. Nuk po duket që opozita ka vullnet dhe as synim për qeveri të tyre”, ka thënë Kurti në Londër.

PËRFUNDON NUMËRIMI I VOTAVE NGA JASHTË KOSOVËS

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 TETOR - Të hënën rreth mesnatës është përmbyllur procesi i numërimit të fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës. Këto fletëvotime i takojnë procesit të votimit jashtë Kosovës, i realizuar përmes postës nga 17 shtatori deri më 11 tetor 2025, të cilat janë tërhequr nga kutitë postare të KQZ-së në 22 shtete të ndryshme si dhe nga kutia postare e KQZ-së në Kosovë. KQZ-ja ka njoftuar se tashmë ka filluar rinumërimi i vendvotimeve dhe numërimi i votave me kusht.

Pas përfundimit të numërimit të votave nga jashtë vendit, në QNR ka nisur rinumërimi i pesë vendvotimeve, sipas urdhrës të PZAP-it. Vendvotimet të cilat do të rinumërohen u takojnë komunave të ndryshme, si: Mitrovicë e Jugut (1110/01 dhe 1110/06), Kamenicë (1019/01 dhe 1020/01) dhe Podujevë (1807/02). Në vazhdim të aktiviteteve të planifikuara, gjatë ditës së sotme në QNR do të fillohet numërimi i fletëvotimeve që i takojnë votimit me kusht dhe atyre nga votimi i personave me nevojë të veçantë. Votimi me kusht është realizuar në

54 vendvotime speciale në 38 komuna, ndërsa votimi i personave me nevojë të veçantë është zhvilluar jashtë vendvotimeve, përmes ekipeve mobile gjatë ditës së zgjedhjeve. Në QNR është duke u zhvilluar procesi i skanimit të Listës së Votuesve. Ky hap është thelbësor për garantimin e integritetit të procesit zgjedhor, pasi skanimi mundëson krahasimin e pjesëmarrësve në votim në vendvotimet e rregullta me ata që kanë votuar me kusht. Qëllimi është të identifikohen rastet eventuale kur një person ka votuar dy herë: në vendvotimin e rregullt dhe në atë me kusht.



RAUNDI I DYTË NË 18 KOMUNA, KUSH DHE ME KË NGA PARTITË POLITIKE GAROJNË NË BALOTAZH?



PRISHTINË, 21 TETOR - Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ka përfunduar procesi i numërimit të fletëvotimeve të ardhura përmes postës nga diaspora. Këto fletëvotime janë dërguar nga 22 shtete të ndryshme. Ndërkohë, pritet të vazhdojë numërimi i fletëvotimeve me kusht dhe atyre të personave me nevojë të veçantë. Sipas rezultateve të deritanishme, 18 komuna do të shkojnë në balotazh, i cili do të mbahet më 9 nëntor 2025. Ndërkaq, në komunën Suharekë dhe Junik, në balotazh do të

garojnë AAK-ja dhe LDK-ja, në Klinë AAK-ja dhe PDK-ja, ndërsa në Gjakovë dhe Rahovec gara do të zhvillohet në mes të AAK-së dhe LV-së. Po ashtu, në Dragash në balotazh do të përballen LDK-ja dhe PDK-ja. Në gjashtë komuna: Fushë-Kosovë, Pejë, Obiliq, Gjilan, Prishtinë dhe Viti, gara do të zhvillohet mes LDK-së dhe LV-së. Ndërsa gara ndërmjet PDK-së dhe LV-së do të zhvillohet në katër komuna: Vushtri, Prizren, Mitrovicë dhe Kaçanik. Sa iu përket subjekteve politike

që do të garojnë në balotazh: Lëvizja Vetëvendosje do të marrë pjesë në 12 komuna, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në 9 komuna, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në 9 komuna, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në 5 komuna, Partia e Turqve të Kosovës (KTDP) në një komunë, Iniciativa e Qytetarëve MHH në një komunë, Lista Serbe (LS) në një komunë, Partia Serbe SNS në një komunë. Në 20 komuna zgjedhjet janë përmbyllur pa nevojën për raund të dytë. /Telegrafi/

Komandanti i KFOR-it dhe ministri Sveçla diskutojnë sigurinë në Kosovë

PRISHTINË, 21 TETOR - Komandanti i KFOR-it në Kosovë, Ozkan Ulutas, ka takuar ministrin e Brendshëm në detyrë, Xhelal Sveçla, me të cilin ka diskutuar për sigurinë në Kosovë dhe bashkëpunimin ndërmjet KFOR-it dhe organizatave të sigurisë së Kosovës. Gjeneral major Ulutas përsëriti angazhimin e KFOR-it për ta kryer misionin në interes të të gjithë qytetarëve në Kosovë. “Komandanti i misionit të udhëhequr nga

NATO, KFOR, gjeneral major Özkan Ulutas, u takua me Xhelal Sveçlën në Prishtinë. Ata ndanë mendime mbi situatën e sigurisë në Kosovë dhe mbi bashkëpunimin ndërmjet KFOR-it dhe organizatave të sigurisë së Kosovës. Gjeneral major Ulutas përsëriti angazhimin e vazhdueshëm të KFOR-it për të kryer misionin e tij në interes të të gjithë njerëzve

që jetojnë në Kosovë. KFOR-i vazhdon të zbatojë mandatin e tij - bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të vitit 1999 - për të kontribuar në një mjedis të sigurt dhe të qetë për të gjithë njerëzit dhe komunitetet që jetojnë në Kosovë dhe në lirinë e lëvizjes, në çdo kohë dhe në mënyrë të paanshme”, thuhet në njoftimin e KFOR-it.





GJYKATA SPECIALE I REFUZON DËSHMITË E KRIMEVE SERBE NË KOSOVË: JANË TË PARËNDËSISHME PËR RASTIN E KRERËVE TË UÇK-së

PRISHTINË, 21 TETOR - Pjesa më e madhe e provave të paraqitura nga mbrojtja e Jakup Krasniqit, që dëshmojnë për krimet serbe të kryera në Kosovë, nuk janë pranuar në rastin e krerëve të Ushtrisë Çlirimtare në Hagë. Kështu kanë vendosur gjyqtarët e rastit, duke theksuar se përgjithësisht këto dëshmi janë komplet të parëndësishme për procesin ndaj Thaçit, Krasniqit, Veselit e Selimit që po zhvillohet në Hagë.

Në vendimin të cilin e ka parë gazeta “Nacionale”, thuhet se nuk është vërtetuar ndonjë ndërlidhje mes aktakuzës dhe provave të cilat dëshmojnë krimet e Serbisë në Kosovë. “Paneli së pari vëren se më parë ka vendosur që provat për krimet e dyshuara të kryera nga forcat serbe janë përgjithësisht të parëndësishme për akuzat kundër të akuzuarit. Mbrojtja e Krasniqit gjithashtu nuk ka arritur të vërtetojë se incidentet e përshkruara në këtë pikë janë të lidhura me ndonjë nga akuzat ose faktet në aktakuzë, ose se ato lidhen me ose janë provuese të organizimit ose aktivitetit të UÇK-së në zonë në një kohë ose vend që lidhet me akuzat”, thuhet në fillim të vendimit.

Por, cilat prova u rrëzuan dhe pse?

Mbrojtja e Jakup Krasniqit kishte dorëzuar materiale të shumta, dëshmi të shkruara, videoincizime të cilat, sipas tyre, dëshmojnë se në Kosovë ka qenë gjendje kaosi dhe shumë krime janë kryer në shenjë hakmarrjeje nga individë pas krimeve të Serbisë në zona të ndryshme.

Pas kërkesës së Jakup Krasniqit, Prokuroria e Hagës kërkoi që këto prova të krimeve serbe të refuzohen. Dhe kështu ndodhi. Pjesa më e madhe e tyre u refuzuan, raporton “Nacionale”.

Prova me numrin 11 përmbante një material të BBC-së, ku kishte videoincizime të ndryshme që dëshmonin për krimet e Serbisë në Kosovë. Megjithatë, kjo për gjyqtarët e Speciales është e parëndësishme. Ata vendosën ta pranojnë një pjesë krejt të shkurtër të materialit, aty ku UÇK-ja u ndihmonte hetimeve të mundshme, por jo edhe dëshmime për krimet e Serbisë. “Duke iu kthyer provës së propozuar 11, paneli vëren

pretendimin e mbrojtjes së Krasniqit se videoja lidhet, ndër të tjera, me pasojat e krimeve serbe të kryera kundër popullsisë shqiptare, natyrën mbrojtëse të organizatës së UÇK-së, pretendimet për përfshirjen e UÇK-së në zhdukjen dhe vdekjen e individëve, trupat e të cilëve u gjetën në rrethana të pashpjegueshme dhe aktet e mundshme të hakmarrjes nga popullsia civile. Pasi shqyrtoi provën e propozuar 11, paneli vëren se pjesa e parë e videos lidhet kryesisht me krimet që dyshohet se janë kryer nga forcat serbe në Rahovec dhe përreth. Paneli kujton qëndrimin e tij se provat e krimeve të dyshuara të kryera nga forcat serbe janë përgjithësisht të parëndësishme për akuzat kundër të akuzuarit. Paneli konsideron se mbrojtja e Krasniqit nuk ka arritur të vërtetojë se pjesa e parë e videos është relevante për këtë çështje”, thuhet në këtë vendim. “Megjithatë, paneli vëren se pjesët pasuese të videos që kanë të bëjnë, ndër të tjera, me gatishmërinë e pretenduar të UÇK-së për të ndihmuar në hetimet e

krimeve, dhe aktet e mundshme të hakmarrjes nga popullsia shqiptare në rast se nuk do të bëheshin arrestime, mund të jenë relevante për çështjen aktuale. Trupi gjykues konsideron se vetëm pjesa e videos që përbëhet nga 17:39-20:15 dhe 34:25-38:00 është treguar e rëndësishme. Mbrojtja e Krasniqit nuk ka arritur ta vërtetojë rëndësinë e pjesëve të mbetura të provës 11 të propozuar”, thuhet më tutje. Gjyqtarët e Hagës e refuzuan një tjetër prove të propozuar nga Jakup Krasniqi, e që lidhej me raportet mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës. Sipas gjyqtarëve, këto nuk janë relevante, ngjashëm siç konstatoi edhe për dëshmitë e krimeve serbe. “Lidhur me provën e propozuar 15, trupi gjykues vëren parashtrimin e mbrojtjes së Krasniqit se ajo lidhet me marrëdhënien midis LDK-së dhe UÇK-së, dhe sugjerimin se ato nuk ishin opozitë dhe kishin qëllime të përbashkëta. Pasi shqyrtoi provën e propozuar 15, trupi gjykues nuk e konsideron përmbajtjen e saj, siç përshkruhet aty, të jetë relevante për qëllimet e

përbashkëta të pretenduara të UÇK-së dhe LDK-së në asnjë mënyrë relevante për këtë çështje. Trupi gjykues vëren se, ndërsa një pjesë e provës së propozuar 15 përmend denoncimin e LDK-së për krimet e kryera nga forcat serbe, kjo pikë është kryesisht relevante për krimet e kryera nga forcat serbe, të cilat janë të parëndësishme përveç nëse lidhen ndryshe me akuzat kundër të akuzuarit. Prandaj, trupi gjykues konstaton se mbrojtja e Krasniqit nuk ka arritur të vërtetojë se prova e propozuar 15 është relevante për këtë çështje”, thuhet më tutje në këtë vendim.

Trupi gjykues vendosi ta pranojë provën me numër 16 që tregon për krimet e ndryshme serbe në Kosovë. Por, jo me arsyetimin e përmbajtjes së tyre apo dëshmisë së krimeve në Kosovë, por me disa përfundime që paneli synon t'i nxjerrë për politikën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. “Lidhur me provën e propozuar 16, paneli vëren parashtrimin e mbrojtjes së Krasniqit se ajo lidhet me krimet e kryera nga forcat serbe dhe me faktin se UÇK-ja nuk kishte nën kontroll

QEVERIA NË PIKËPYETJE: AFATI AFROHET, SHENJA NUK KA

Negociatat e Vetëvendosjes me partitë e tjera për formimin e qeverisë mbeten të paqarta dhe pa rezultate konkrete. Marrëveshja e kandidatit të LDK-së në Vushtrri me Vetëvendosjen shkaktoi reagime të forta nga qendra e partisë. Afati për prezantimin e qeverisë skadon më 26 tetor, ndërsa ankesa e Listës Serbe në Kushtetuese mund ta vështirësojë më tej procesin

PRISHTINË, 21 TETOR - Gjysma e afatit kushtetues për formimin e qeverisë së re të Kosovës ka kaluar, ndërsa në skenën politike të vendit mbizotëron paqartësia.

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, deri më tani ka dhënë vetëm një zotim publik, se “do t’i nisim negociatat”, por pa sinjale konkrete për ndonjë marrëveshje apo shumicë të mundshme. Partia e tij, Lëvizja Vetëvendosje, gjendet nën presion të madh për të siguruar mbështetje në Kuvend, pasi zgjedhjet e 9 shkurtit e lanë larg shumicës së nevojshme për të qeverisur e vetme.

Opsionet janë të kufizuara: Vetëvendosja ka përjashtuar bisedimet me Partinë Demokratike të Kosovës, e cila doli e dyta në zgjedhje, ndërsa ka lënë të hapur derën për një bashkëpunim të mundshëm me Lidhjen Demokratike të Kosovës. Pavarësisht prej përpjekjeve të “Radios Evropa e Lirë”, zëdhënësi i Vetëvendosjes, Arlind Manxhuka, nuk u përgjigj mbi ecurinë e negociatave.


Disa deputetë të partisë konfirmuan se “nuk janë në dijeni për ndonjë bisedë me parti të tjera parlamentare”, duke shtuar se “mbetet për t’u parë”. Gjithashtu, zyrtarë të lartë të Lidhjes Demokratike të Kosovës,

duke folur në kushte anonimiteti, thanë se deri tani “nuk ka pasur as takime e as ftesa për të diskutuar një koalicion të mundshëm”. “Vetëvendosje po vepron përmes individëve, jo me ne si subjekt politik”, tha një prej tyre. “Nuk mund të supozoj nëse do të ketë diçka konkrete në të ardhmen”, shtoi ai.

Deklaratat pasuan raportimet se kandidati i LDK-së për kryetar të Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, kishte nënshkruar një marrëveshje për koalicion me Vetëvendosjen për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale më 9 nëntor, kur në balotazh garojnë PDK-ja dhe LV-ja.

LDK-ja qendrore e dënoi këtë veprim, duke e cilësuar si “individual, të papranueshëm dhe në kundërshtim me procedurat statutores” të partisë. Ndërsa dega lokale e LDK-së në Vushtrri tha se “qyteti ka nevojë për ndryshim”. “Vendimet e mëdha nuk janë asnjëherë të lehta por, pavarësisht prej kostove individuale, për ne një gjë është e qartë - interesi i qytetarëve dhe i Vushtrrisë është mbi gjithçka. Marrëveshja jonë nuk afekton asnjë garë tjetër përveç Vushtrrisë”, thuhet në postimin e saj në “Facebook”.

Tahiri nuk iu përgjigj thirrjeve të “REL”-it për komente.



Analisti politik Artan Muhaxhiri e sheh këtë marrëveshje si një lëvizje të Kurtit për ta fragmentuar LDK-në dhe për ta paraqitur si parti të paaftë në vendimmarrje, të cilën mund ta shfrytëzojë pastaj për avantazh elektoral. “Dihet hendeuku mes LV-së dhe LDK-së. Duhet shumë punë, angazhim dhe garanci që të arrihet një koalicion në secilën komunë. Ai nuk mund të bëhet lehtë e shpejt, pa koordinim me qendrën”, thotë Muhaxhiri për “Radion Evropa e Lirë”.

Ai shton se për momentin nuk ka asnjë shenjë që Kurti po punon për të siguruar 61 votat e nevojshme për formimin e qeverisë.

Qasja e tij, shpesh e shpërfillshme ndaj partive të

tjera, ka dëmtuar marrëdhëniet e mundshme për bashkëpunim, sipas Muhaxhirit. “Me kohën që ka mbetur, më realiste duket mundësia e zgjedhjeve të reja sesa arritja e një marrëveshjeje koalicioni”, thekson ai.

Afati kushtetues prej 15 ditësh për prezantimin e qeverisë së re skadon më 26 tetor, pastaj presidentja Vjosa Osmani brenda 10 ditësh duhet t’i ftojë partitë në konsultim dhe, sipas diskrecionit të saj, t’ia japë mandatin një kandidati tjetër që dëshmon se ka shumicën parlamentare. Osmani tha të hënën se ka ende kohë për të arritur këtë qëllim, duke kritikuar njëkohësisht Listën Serbe për, siç theksoi, krijimin e pengesave.

Lista Serbe, partia më e madhe e

komunitetit serb në Kosovë, dorëzoi javën e kaluar një ankesë në Gjykatën Kushtetuese kundër zgjedhjes së nënkryetarit serb të Kuvendit, Nenad Rashiq, duke pretenduar shkelje të Kushtetutës dhe të rregulloreve të brendshme. Ankesa u paraqit më pak se një javë pas konstituimit të Kuvendit - një proces që zgjati pothuajse gjashtë muaj. Ekspertët paralajmërojnë se në varësi të vendimit të Kushtetueses, procesi mund të rifillojë nga zeroja dhe Kuvendi të mos konsiderohet i konstituuar.

I pyetur nga gazetarët për ankesën e Listës Serbe, kryeparlamentari Dimal Basha u përgjigj shkurt: “Kanë të drejtë të ankohen”.

OVLUÇK dënon vendimin e Speciales për refuzimin e provave për krimet serbe: Fyerje për drejtësinë



PRISHTINË, 21 TETOR - Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) ka reaguar ndaj vendimit të Dhomave të Specializuara në Hagë të cilat kanë refuzuar shumicën e provave të paraqitura nga mbrojtja e Jakup Krasniqit - prova që dokumentojnë krimet e kryera nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë. “Ky veprim

është i papranueshëm dhe përbën një tjetër dëshmi të qasjes së njëanshme të kësaj gjykate, e cila po përpiket ta paraqesë luftën çlirimtare të popullit të Kosovës jashtë kontekstit të saj historik, duke mohuar krimet që sollën shkatërrim dhe gjenocid në vendin tonë. Të shpallësh të ‘parëndësishme’ dëshmitë për masakrat dhe krimet serbe, do

të thotë të mohosh të vërtetën dhe dhimbjen e një populli që luftoi për liri. Kjo është një fyerje për drejtësinë dhe kujtesën historike të Kosovës. Ky vendim i padrejtë është edhe një arsye më shumë për të protestuar dhe për të ngritur zërin kundër kësaj padrejtësie që po u bëhet çlirimtarëve të Kosovës”, është thënë në reagimin e OVLUÇK-së.

të gjithë individët që kryenin krime pas përfundimit formal të konfliktit. Pasi shqyrtoi provën e propozuar 16, paneli vëren se një pjesë e kësaj pike u referohet krimeve që dyshohet se i janë fajësuar UÇK-së dhe akteve të dhunës që dyshohet se janë kryer në mënyrë sporadike nga popullsia shqiptare në Rahovec. Duke marrë parasysh se këto ngjarje nuk lidhen me asnjë nga krimet e akuzuara dhe lidhen vetëm në

distancë me rrethanat relevante për këtë çështje, paneli e gjen pretendimin e rëndësisë për këtë çështje të dobët. Paneli gjithashtu konsideron se prova e propozuar 16 mund të jetë paksa relevante për disa përfundime që paneli ftohet të nxjerrë në lidhje me politikën e UÇK-së për të synuar kategori të caktuara individësh dhe atribuimin e një sjelljeje të tillë të akuzuarve ose atyre që lidhen me ta”, thuhet në vendim.

U refuzuan edhe dëshmitë 18 dhe 19, të cilat dëshmonin për situatën e vështirë të kthimit të refugjatëve në Kosovë. Edhe këto, për gjyqtarët, janë të parëndësishme. “Lidhur me provat e propozuara 18 dhe 19, paneli vëren parashtrimin e mbrojtjes së Krasniqit se ato lidhen, ndër të tjera, me krimet e kryera në gusht 1999, praninë e KFOR-it (KFOR) dhe situatën pas luftës në Rahovec. Mbrojtja e Krasniqit nuk ka arritur të

shpjegojë se si lidhet një informacion i tillë me akuzat ose me rastin e saj në përgjigje të tyre. Pasi ka shqyrtuar provën e propozuar 19, paneli nuk është i bindur se ajo është relevante për rastin aktual. Lidhur me provën e propozuar 18, paneli vëren se ajo lidhet me praninë dhe kontrollin e KFOR-it mbi Rahovec në gusht 1999. Mbrojtja e Krasniqit nuk ka arritur të përcaktojë se si ky fakt do të ishte relevant për

rastin. Kështu, mbrojtja e Krasniqit nuk ka arritur të përcaktojë se provat e propozuara 18 dhe 19 janë relevante”, thuhet më tutje në vendimin e Gjykatës Speciale. Për këto prova ditë më parë Prokuroria Speciale e Hagës kërkoi që të mos pranohen. Në anën tjetër, muaj më parë Gjykata Speciale kishte pranuar prova që zyrtarisht u takonin institucioneve të Beogradit zyrtar.

LDK-ja dhe Nisma arrijnë koalicion për balotazhin në Fushë-Kosovë

FUSHË-KOSOVË, 21 TETOR - Kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës për kryetar të Fushë-Kosovës, Besnik Osmani, ka bërë me dije se ka arritur një marrëveshje bashkëpunimi me Nismën Socialdemokrate për raundin e dytë të zgjedhjeve më 9 nëntor. Në “Facebook”, Osmani nuk ka

zbuluar hollësi rreth marrëveshjes, por ka theksuar se synimi i përbashkët është fitorja dhe qeverisja në interes të qytetarëve. “Vazhdojmë me Nismën drejt fitores! Së bashku për qytetarët dhe të ardhmen e komunës sonë”, shkroi Osmani. Kryetari i Nismës në këtë komunë, Driton Ademi, deri

tani nuk ka dalë me një reagim publik lidhur me këtë marrëveshje. Në zgjedhjet e 12 tetorit, Osmani i LDK-së u radhit i dyti me 7 840 vota ose 36.63 %, ndërsa kundërshtari i tij në balotazh, kandidati i LV-së për kryetar të Fushë-Kosovës, Valon Prebreza, është radhitur i pari me 9 669 vota ose 45.18 %.



RRITJE E NUMRIT TË FILMAVE TË SHFAQUR GJATË VITIT 2024



PRISHTINË, 21 TETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e kulturës për vitin 2024. Gjatë vitit 2024 janë realizuar 21 ekspozita në galeritë e artit që, krahasuar me vitin e kaluar, ka pasur rënie të numrit të ekspozitave për (- 25 %). Ndërsa numri i vizitorëve ishte 40 500 që, krahasuar me vitin paraprak, ka pasur rënie për (-14,6 %). Shfaqje/premiera dhe ngjarje të tjera në teatro, gjithsej janë realizuar 564 që, krahasuar me vitin e kaluar, ka pasur rritje të numrit të shfaqje/premierave dhe ngjarjeve të tjera në teatro për 12,8 %. Ndërsa numri i spektatorëve në vitin 2024 ishte 50 365 që, krahasuar me vitin paraprak, ka pasur rënie për (- 9,9 %). Janë shfaqur gjithsej 792 filma të huaj dhe vendorë që, krahasuar me vitin e kaluar, ka pasur rritje për 0,7 %, ndërsa numri i shikuesve në këtë vit ishte 164 473 që, krahasuar me vitin e kaluar, ka pasur rënie për (-37,4 %).

Përqindja e femrave që përbëjnë shumicën e studentëve në fushat e studimit që lidhen me kulturën, në vitin akademik 2024/2025 ishte 64,2 %. Përqindja e femrave është më e lartë në fushat: Gjuhë (83,9 %); Gazetari dhe informim (82,4 %); Arte (66,7 %); dhe Shkenca humane (54,7 %). Ndërsa fushat ku femrat e përbëjnë përqindjen më të ulët janë: Arkitekturë dhe ndërtim (49,9 %) dhe Sporte (30,5 %). Në vitin 2024 janë punësuar 4 166 individë në një aktivitet kulturor ose në një profesion kulturor, ose gjithsej 1 % e punësimit. Krahasuar me vitin e kaluar, punësimi në kulturë ka rënie për (-0,1 %) në punësimin e përgjithshëm. Në analizën sipas aktiviteteve të kryera në internet, gjatë tre muajve të fundit të vitit 2024, të dhënat sipas gjinisë tregojnë se femrat e përdorin më shumë internetin për të blerë: rroba (duke përfshirë veshjet sportive), këpucë, aksesore (çanta, bizhuteri etj.), 40 %.

MOSPARAQITJA E DËSHMITARES SHTYN SEANCËN PËR BANJSKËN

PRISHTINË, 21 TETOR - Në Gjykatën Themelore në Prishtinë është anuluar seanca kundër tre të akuzuarve për terrorizëm në veri të Kosovës - Blagoje Spasojeviq, Vladimir Toliq dhe Dushan Maksimoviq - për shkak të mungesës së njërës prej dëshmitareve në sallën e gjyqit. Kryetari i trupit gjykues, Arben Hoti, ka thënë se në vend të dëshmitares, ftesën e ka pranuar babai i saj, i cili ka njoftuar se Dragana Antonijeviq është aktualisht në Serbi. Për shkak të kësaj, seanca e planifikuar për rastin “Banjska” është shtyrë.

Gjykata e Prishtinës ka paralajmëruar se do ta shqyrtojë mundësinë e lëshimit të një urdhërese policore për ta sjellë dëshmitaren në seancën e ardhshme. Në seancën e radhës, më 27 nëntor, do të dëshmojë një person nga Maqedonia e Veriut. Të hënën ka dëshmuar dëshmitari anonim “A2” për sulmin terrorist në Banjskë. Ai është dëgjuar në seancë të mbyllur për publikun, meqë Prokuroria Speciale ka vlerësuar se dëshmia e tij në një seancë publike mund t’ia cenojë sigurinë personale.

Disa pjesëtarë të Policisë së Kosovës kanë dëshmuar për prokurorinë deri më tani prej se filloi rasti “Banjska” më 17 prill. Tre nga 45 të akuzuarit për sulmin terrorist në fshatin Banjskë të Zveçanit në shtator të vitit 2023 janë deklaruar të pafajshëm. Përgjegjësinë për organizimin e sulmit e ka marrë Millan Radoiqiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe - forca më e madhe politike e serbëve në Kosovë - që gëzon përkrahjen e Serbisë, për të cilin ekziston një urdhërarrest ndërkombëtar.



Punëtorja përmbyllëse e projektit “NanoKos”, dy ditë reflektimi, bashkëpunimi dhe kërkimi shkencor

PRISHTINË, 21 TETOR - Më 16 dhe 17 tetor në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës u mbajt punëtorja përmbyllëse e projektit “NanoKos”, një iniciativë e

financuar nga Bashkimi Evropian, që ka synuar forcimin e kapaciteteve kërkimore në Kosovë në fushën e nanopartikujve në shëndet dhe

mjedis. Ngjarja dyditore mbledhi partnerët ndërkombëtarë nga Universiteti i Milanos, Universiteti i Parmës dhe King’s

College London, si dhe stafin akademik dhe administrativ të Universitetit të Prishtinës për të reflektuar mbi arritjet, përvojat dhe bashkëpunimet e ardhshme.



Në Hajvali gjenden mbetje mortore që dyshohet të jenë të personave të zhdukur në luftë

PRISHTINË, 21 TETOR - Policia e Kosovës ka bërë me dije se njësitë e saj, në koordinim me Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur, kanë kryer gërmime në varrezat e fshatit Hajvali të Prishtinës më 20 tetor dhe kanë gjetur mbetje eshtërore të njeriut, që dyshohet të jenë të paktën të tre personave të zhdukur gjatë luftës në Kosovë më 1998-1999.

Policia ka thënë se urdhri është dhënë nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Sipas këtij institucioni, mbetjet

mortore janë tërhequr nga Instituti i Mjekësisë Ligjore për ekzaminime dhe që punimet do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim.

Gjatë luftës së viteve 1998/'99 në Kosovë janë vrarë rreth 13 000 njerëz, ndërsa mbi 1 500 vazhdojnë të jenë të zhdukur.

Shumica e të vrarëve ishin civilë shqiptarë.

Kosova dhe Serbia patën arritur pajtueshmëri më 2023 për Deklaratën e Përbashkët për Personat e Zhdukur në kuadër të dialogut për normalizimin e

marrëdhënieve të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Në mesin e zotimeve të bëra ishin: qasja e plotë në informacione të besueshme, mes tyre edhe ato me status të klasifikuar; vënja në dispozicion të të gjitha dokumenteve me rëndësi për përcaktimin e fatit të personave të zhdukur, si dhe puna e përbashkët përmes një komisioni të kryesuar nga Bashkimi Evropian. Megjithatë, gjithçka vazhdon të mbetet në letër, meqë asnjëra pikë nuk është zbatuar.



KURTI TAKON MËRGATËN SHQIPTARE NË MBRETËRINË E BASHKUAR, FTON PËR INVESTIME NË KOSOVË

LONDËR, 21 TETOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, e nisi qëndrimin e tij në Mbretërinë e Bashkuar mbrëmë përmes takimit me mërgatën shqiptare në Londër.

Mes bashkëbisedimeve me diasporën, kryeministri Kurti mbajti edhe një fjalë rasti. Ai shprehu se partneriteti i Kosovës me Mbretërinë e Bashkuar është ndërtuar mbi shtylla si bashkëpunimi në mbrojtje dhe siguri, zhvillimi ekonomik dhe diplomacia. Ai shtoi se ky partneritet forcon lidhjet tona dypalëshe, nxit shkëmbimin e njohurive dhe kontribuon në paqe, stabilitet dhe mirëqenie të ndërsjellë.



Në vijim, kryeministri foli rreth të arriturave të qeverisë përgjatë këtij mandati, të ndërlidhura me bashkëpunimin me Britaninë e Madhe, duke veçuar investimet në fushat e mbrojtjes dhe

sigurisë, katërfishimi i buxhetit të mbrojtjes, trajnimet e anëtarëve të FSK-së dhe pajisja me sisteme të reja; rritja ekonomike me mesatare prej 6 %, gjersa janë rritur të hyrat

buxhetore, janë mbështetur qytetarët dhe ndërmarrësit prodhues e janë forcuar lidhjet tregtare dhe investimet nga Mbretëria e Bashkuar.

Kryeministri theksoi rëndësinë e diasporës sonë, krahas përkrahjes dhe vëmendjes së qeverisë ndaj mërgimtarëve tanë. Përmes programit Citizen Diplomacy Felloëship po sjellim profesionistë të rinj nga diaspora në sektorin publik, duke u mundësuar të kontribuojnë me ekspertizë dhe të formësojnë të ardhmen e Kosovës përmes angazhimit profesional dhe qytetar, ndërsa me lansimin e Dritares së Investimeve të Diasporës, pjesë

e Fondit të Garancisë Kreditore, i mundësojmë diasporës të marrë kredi investimi pa kolateral, duke sjell idetë dhe përvojën e biznesit të tyre në atdhe dhe duke ndihmuar në këtë mënyrë rritjen ekonomike të Kosovës. Duke e ftuar diasporën që të vijë e të investojë në Kosovë, kryeministri shprehu gatishmërinë dhe vullnetin e qeverisë për ta thelluar bashkëpunimin dhe ngritur iniciativë të tjera të reja që sjellin mërgatën më pranë vendit tonë dhe nxisin zhvillimin dhe përparimin e shtetit. Në këtë ngjarje ishte edhe ambasadori i Kosovës në Britaninë e Madhe, Ilir Kapiti.

PRESIDENTJA OSMANI ORGANIZON DARKËN E LAMËS

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 TETOR - Nën organizimin e presidentes së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, mbrëmë u mbajt Darka Tradicionale e Lamës në prani të ambasadorëve të vendeve mike si dhe të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore dhe të jetës shoqërore.

Në fjalën e saj para të pranishmëve, Osmani theksoi se toka është rrënjë që mban çdo komb të bashkuar dhe dëshmia më e qartë se puna dhe përkushtimi sjellin begatinë dhe suksesin.

Presidentja Osmani kujtoi se kjo

darkë është nismë e ish-presidentit Ibrahim Rugova, njëkohësisht shprehje e urtësisë së tij se kombi forcohet me punë, dije dhe dashuri ndaj tokës që na ushqen.

Më tej, Osmani vuri në pah sukseset e prodhimeve vendore që tashmë njihen edhe jashtë Kosovës, si ajvari i grave të Krushës, verërat e Rahovecit e Suharekës, si dhe rrushi, mjalti, frutat, çajrat e shumë produkte të tjera, duke theksuar se këto produkte nuk janë vetëm mallra ekonomike, por edhe tregim i punës, pasionit dhe përkushtimit të njerëzve të Kosovës.

Në përmbyllje, presidentja



theksoi se Darka e Lamës është më shumë se një festë e bereqetit, është një moment reflektimi dhe falënderimi për punën, bashkimin dhe shpirtin e

mirënjohjes që e karakterizon popullin e Kosovës.

Ajo shprehi mirënjohje për aleatët që qëndruan gjithnjë pranë nesh, për institucionet e

sigurisë që mbrojnë sovranitetin e vendit dhe sigurinë e qytetarëve, për punonjësit shëndetësorë e arsimorë, organizatat e të drejtave të njeriut dhe shumë përfaqësues të tjerë të cilët u mblodhën për ta festuar këtë traditë të lashtë të popullit tonë. "Darka e Lamës është një festë e mirënjohjes ndaj: punëtorit, fermerit, ndaj begatisë, ndaj natyrës që na fal, dhe ndaj Zotit që na jep bekim. Është moment për të kujtuar se fuqia e një kombi nuk matet vetëm me numrat në ekonomi, por me lidhjen shpirtërore që ai ka me tokën e vet dhe me traditën", ka theksuar presidentja Osmani.

Policët e lagjes bëhen me vetura të reja

PRISHTINË, 21 TETOR - Menaxhmenti i Policisë së Kosovës në vazhdimësi ka synuar rritjen e efikasitetit në punën e policëve të lagjes, me qëllim që ata të jenë sa më afër komunitetit dhe nevojave të qytetarëve.

Përmeshja e objektivave të

Strategjisë së Policimit të drejtuar nga Inteligjenca dhe Policimi në Bashkësi, si dhe forcimi i qasjes proaktive ndaj kërkesave të qytetarëve, tashmë mundësohet më lehtë dhe më shpejt falë pajisjes me automjete zyrtare. Drejtori i përgjithshëm i Policisë, kolonel Gazmend Hoxha, ka

vazhduar mbështetjen ndaj Drejtorisë së Policisë në Bashkësi dhe Parandalim, konkretisht për sektorët ku shërbejnë policët e lagjes, duke ndarë nëntëmbëdhjetë vetura të reja hybride për mbulimin e zonave sektoriale në të gjitha drejtoritë rajonale.

Kjo edhe një herë dëshmon përkushtimin e menaxhmentit të policisë për një qasje gjithnjë e më proaktive ndaj komunitetit, për forcimin e bashkëpunimit dhe komunikimit me qytetarët, si dhe për rritjen e mëtejme të besueshmërisë dhe transparencës institucionale.



Pensionistët mbi 80 vjeç dhe ata me probleme shëndetësore mund të lajmërohen nga shtëpia

PRISHTINË, 21 TETOR - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ka bërë me dije se tashmë është funksionalizuar shërbimi i ekipeve mobile që vizitojnë në shtëpi pensionistët të cilët, për arsye shëndetësore, nuk janë në gjendje të paraqiten fizikisht në zyrat e pensioneve për procesin e lajmërimit periodik. MF-ja ka njoftuar se ekipet

mobile punojnë shtatë ditë në javë për të siguruar që të gjitha familjet të vizitohen në kohë dhe në mënyrë të rregullt. “Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve sqaron për opinionin publik se tashmë ekzistojnë ekipet mobile që vizitojnë në shtëpi pensionistët që duhet të lajmërohen çdo gjashtë (6) muaj, por e kanë të pamundur ta bëjnë këtë në

zyrat e pensioneve për shkak të arsyeve shëndetësore. Që nga muaji gusht 2023, Ministria e Financave ka lansuar projektin e lajmërimit në shtëpi të pensionistëve, përmes ekipeve mobile që vizitojnë pensionistët në adresën e tyre të banimit. Me qëllim të lehtësimit të procedurave, pensionistët me probleme shëndetësore si dhe ata mbi

moshën 80 vjeçare mund të dërgojnë kërkesë përmes telefonit ose e-mailit, dhe ekipi mobil i Ministrisë shkon në shtëpi për të realizuar procesin e verifikimit. Kërkesën mund ta bëjë vetë pensionisti dikush nga familjarët, mjafton të ofrohen të dhënat e sakta të pensionistit dhe arsyet e kërkesës”, ka njoftuar Ministria e Financave.



DELEGACIONI I BQK-së PËRFUNDON ME SUKSES TAKIMET VJETORE 2025 TË FMN-SË DHE BB-SË

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

UASHINGTON, 21 TETOR - Delegacioni i lartë i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), kryesuar nga guvernatori Ahmet Ismaili, ka marrë pjesë në Takimet Vjetore 2025 të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore (BB) të cilat u zhvilluan në Uashington të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Gjatë takimeve që u zhvilluan nga 13 deri më 18 tetor, guvernatori Ismaili dhe zëvendësguvernatori Cakaj para drejtuesve të FMN-së, BB-së, Thesarit Amerikan si dhe me përfaqësues të bankave qendrore partnere, kanë paraqitur zhvillimet kryesore dhe prioritetet në sektorin financiar të Republikës së Kosovës, rezultatet nga zbatimi i programeve dhe asistencave teknike profesionale, si dhe nevojat për mbështetje të mëtejshme teknike.

Guvernatori Ismaili në panelin e FMN-së të nivelit të lartë “Fuqizimi i qëndrueshmërisë së sistemit financiar në kohë të pasigurive - ndërtimi i kapaciteteve në vendet në zhvillim dhe në tranzicion”, paraqiti arritjet kryesore të sistemit financiar të Kosovës, kontributin e FMN-së, duke përfshirë Rishikimin e Stabilitetit të Sektorit Financiar (FSSR), në ndërtimin e kapaciteteve institucionale, reformimin e kornizës mbikëqyrëse dhe rregullative, që kanë rezultat me një sistem financiar stabil që mbështet sektorin privat, rritjen ekonomike dhe stabilitetin financiar të vendit.



Pjesëmarrja e guvernatorit Ismaili në këtë panel bashkë me drejtues të lartë të FMN-së dëshmon përparimin e vazhdueshëm dhe arritjet konkrete të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, e shfaqur para një audience të gjerë ndërkombëtare në një sesion të transmetuar drejtpërdrejt nga FMN-ja.

I pari i BQK-së në sesionin e mëngjesit të nivelit të lartë “Nxitja e produktivitetit në Evropë dhe Azinë Qendrore”, gjatë ndërhyrjes së tij në temën “Nxitja e adoptimit të teknologjisë dhe digjitalizimit”, vuri në dukje se popullsia e re dhe sektori dinamik i teknologjisë informative dhe

komunikimit në Kosovë ofrojnë potencial të fortë për ta nxitur rritjen e produktivitetit.

Nga këndvështrimi i sektorit financiar, guvernatori Ismaili vuri theksin në rëndësinë e transformimit digjital gjithëpërfshirës përmes investimeve në aftësi digjitale dhe shërbime publike digjitale, për të siguruar që grupet e popullsisë të përfitojnë në mënyrë të barabartë.

Gjatë takimeve vjetore të mbajtura në Uashington guvernatori Ismaili mori pjesë në ceremoninë për nënshkrimin e Letrës së Qëllimit për projektin e pagesave të shpejta - TIPS Clone në kuadër të projektit rajonal për zhvillimin e sistemit të pagesave të shpejta, e cila u nënshkrua

ndërmjet Bankës së Italisë, Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës si dhe bankave qendrore të Shqipërisë, Malit të Zi, Bosnjë-Hercegovinës dhe Maqedonisë së Veriut.

Ky projekt përfaqëson iniciativën më të rëndësishme infrastrukturore dhe strategjike të BQK-së, duke kontribuar në realizimin e objektivave dhe Planit Strategjik të institucionit. Në vazhden e takimeve me guvernatorë të bankave qendrore, delegacioni i BQK-së zhvilloi takim me delegacionin e Bankës Kombëtare Zvicerane (SNB), udhëhequr nga kryetari i Bordit Drejtues, Martin Schlegel, duke e informuar për zhvillimet e fundit në sektorin financiar dhe

reformat e tjera të ndërmarra drejt harmonizimit me kornizën ligjore të Bashkimit Evropian. Veçanërisht ai ka informuar mbi përparimin e bërë dhe veprimet e ndërmarra nga BQK-ja për anëtarësim në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA), modernizimin e sistemit të pagesave të shpejta, si dhe prioritetet e tjera nga plani strategjik.

Delegacioni i lartë i BQK-së zhvilloi takim me shefin e Misionit të FMN-së për Kosovën, David Amaglobeli, si dhe me Sebastian Sosa, përfaqësues rajonal rezident për Ballkanin Perëndimor në FMN.

Diskutimet u fokusuan në zhvillimet më të fundit ekonomike dhe në reformat në vazhdim në sektorin financiar të Kosovës, duke përfshirë asistencën teknike që FMN-ja po ofron në fusha të ndryshme të mandatit të BQK-së.

Guvernatori Ismaili paraqiti ecurinë e fundit të ekonomisë dhe sektorit financiar, me theks në forcimin e mbikëqyrjes bankare, zhvillimin e mekanizmave të përmbylljes, politikën makroprudenciale, modernizimin e infrastrukturës së pagesave dhe reformat e tjera kyçe që janë në proces.

Takimet vjetore të FMN-së dhe të BB-së mbledhin së bashku bankierë qendrorë, ministra të financave dhe zhvillimit, parlamentarë, drejtues të sektorit privat, përfaqësues të shoqërisë civile dhe akademikë, për të diskutuar çështje me rëndësi globale, si perspektivat ekonomike, lufta kundër varfërisë dhe zhvillimi ekonomik.

Më pak thëngjill i prodhuar në korrik të 2025-s sesa në korrik të 2024-s

PRISHTINË, 21 TETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e energjisë për muajin korrik 2025 me të dhëna për prodhimin dhe konsumin e thëngjillit, prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e energjisë, si dhe importin dhe eksportin e energjentëve të tjerë.

Gjatë muajit korrik të vitit

2025 energjia elektrike bruto në dispozicion ishte 508.65 GWh, kurse konsumi i energjisë elektrike ishte 397.97 GWh ose (-1,12 %) më i vogël me muajin e njëjtë të vitit paraprak.

Pjesëmarrja e energjisë elektrike alternative në kuadër të konsumit të përgjithshëm ishte 8,35 %.

Importi i energjisë elektrike

në korrik të vitit 2025 ishte 337.64 GWh, kurse eksporti i energjisë elektrike në të njëjtën periudhë ishte 244.16 GWh. (këtu janë të përfshira edhe sasitë e transmisionit).

Prodhimi i thëngjillit për muajin korrik 2025 ishte rreth 380.481 mijë tonë që paraqet një rënie prej (-39,77 %) në krahasim me të njëjtin muaj të vitit të kaluar.



ASAMBLISTI MË I VOTUAR I VUSHTRRISË FITOREN IA DEDIKON GJYSHIT **NUREDIN GUBETINI** DHE ISH-PRESIDENTIT **HASHIM THAÇI**



Në komunën e Vushtrisë, ashtu si në gjithë Kosovën, më 12 tetor është zhvilluar një garë mjaft interesante për asamblistë nga të gjitha partitë politike. Ndër kandidatët më të votuar për Asamblenë Komunale ka dalë i riu nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Xhon Gubetini, i cili rrjedh nga familja e njohur patriotike Gubetini.

Sipas rezultateve përfundimtare, Xhoni ka arritur të sigurojë 870 vota, duke lënë pas kandidatët e tjerë të të gjitha partive me një diferencë të konsiderueshme.

Xhon Gubetini ka garuar me numrin 28 dhe tashmë është bërë numri një në listën e PDK-së për nga votat e fituara, menjëherë pas kandidatit për kryetar të komunës, Ferit Idrizi. Kjo e bën atë një nga figurat më të reja dhe më premtuese të PDK-së në Vushtri, me mbështetje të gjerë nga votuesit e komunës.

Pas shpalljes së rezultateve,



Xhoni ka falënderuar çdo votues, familjen e tij, si dhe miqtë e përkrahësit e PDK-së, duke theksuar se falë tyre kjo fitore mori kuptim.

Ai ka kujtuar edhe një takim që e ka përjetuar si i ri me ish-presidentin Hashim Thaçi:

“Këtë ditë e ndjej të veçantë, sepse më kujton momentin kur Presidenti Hashim Thaçi nderoi gjyshin tim, Nuredin Gubetin, me Medaljen Presidenciale. Me atë rast, presidenti më dhuroi librin ‘A New State, a Modern Statesman’ (Shteti i ri, burrë shteti modern) dhe më tha me buzëqeshje: ‘Lexoje edhe për gjyshin tënd.’ Duke qenë se e njoh shumë mirë gjuhën angleze, pata mundësinë të lexoja dhe t’ia komentoja gjyshit tim këtë vepër me shumë dashuri e krenari. Ishte një moment që do ta mbaj gjithmonë në kujtesë — një porosi që më udhëheq në çdo hap,” ka shkruar Xhon Gubetini, ylli i ri i asamblesë së Vushtrrisë.



Falënderimi i plotë i tij:

Urim dhe falënderim nga zemra!

Të dashur miq, bashkëqytetarë, familjarë e përkrahës, Rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve lokale në Vushtri konfirmuan një lajm që më mbush me krenari e mirënjohje:

Unë, Xhon Gubetini, jam kandidati më i votuar për Asamblenë Komunale, nga të gjitha subjektet politike!

Ky sukses është i yni, i çdo qytetari që besoi në punën, përkushtimin

dhe vizionin për një Vushtri më të drejtë, më të zhvilluar dhe më shpresëplotë.

Falënderimet më të sinqerta për çdo votues, për familjen time, miqtë e përkrahësit e PDK-së — falë jush kjo fitore mori kuptim!

Këtë ditë e ndiej të veçantë, sepse më kujton momentin kur Presidenti Hashim Thaçi nderoi gjyshin tim, Nuredin Gubetin, me Medaljen Presidenciale. Me atë rast, presidenti më dhuroi librin “*A New State, a Modern Statesman*” (Shtet i ri, burrë shteti modern) dhe

më tha me buzëqeshje:


“Lexoje edhe për gjyshin tënd.”

Duke qenë se e njoh shumë mirë gjuhën angleze, pata mundësinë ta lexoj dhe t’ia komentoj gjyshit tim këtë vepër me shumë dashuri e krenari. Ishte një moment që do ta mbaj gjithmonë në kujtesë — një porosi që më udhëheq në çdo hap. Faleminderit Vushtri, për besimin dhe dashurinë!

Krenar që jam pjesë e brezit që po e ndryshon Vushtrrinë për të mirë.

Xhon Gubetini
Kandidati juaj!





Alan Herndon, MVP i javës së dytë në basketboll

Prishtinë, 21 tetor - Java e dytë e Superligës së Kosovës në basketboll ka sjellë shumë sfida interesante. Pas përfundimit të xhiros së dytë, Federata e Basketbollit e Kosovës ka shpallur MVP-në e javës si dhe pesëshen më të mirë.

GO+ Peja ka fituar në derbin e javës ndaj Golden Eagle Yllit, ku Alan Herndon kishte dyshifror të dyfishtë me 13 pikë e dhjetë kërcime, duke pasur indeksin 21, apo më të lartin në këtë sfidë. Herndon është shpallur MVP i javës së dytë. Ai është ndihmuar

nga Malcolm Armstead me 18 pikë, tri kërcime e shtatë asistime. Batin Tuna është dalluar te Trepça në fitoren e lartë ndaj Vëllaznimit me 24 pikë, dhjetë kërcime e gjashtë asistime. Arian Azemi ishte më i miri te Sigal Prishtina në fitoren ndaj Borës

me 19 pikë, pesë kërcime dhe nëntë asistime. Lejson Zeqiri ishte më meritori për fitoren e Bashkimit ndaj Rahovecit 029. Zeqiri ka shënuar pesë pikë në fund të ndeshjes, derisa e mbylli ndeshjen me 17 pikë, dhjetë kërcime e një asistim.



KOMBËTARJA E KOSOVËS GRUMBULLOHET PËR DY NDESHJET E “PLAY-OFF”-IT NDAJ TURQISË, OBJEKTIV KTHIMI NË LIGËN B

PRISHTINË, 21 TETOR - Kombëtarja e Kosovës në konkurrencën e vazhduar ka nisur fazën përgatitore për dy ndeshjet vendimtare ndaj Turqisë në kuadër të “play-off”-it të Ligës së Kombeve. Ndeshja e parë do të zhvillohet në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë të premten, ndërsa ajo e dytë në udhëtim në Izmir, ku “dardanet” do të kërkojnë ta realizojnë objektivin e tyre, rikthimin në Ligën B. Nga ana tjetër, Turqia hyn në këto dy përballje me synimin për të mbetur në Ligën B. Përzgjedhësi i Kosovës, Sami Sermahaj, të dyja ndeshjet me Turqinë i ka konsideruar finale. “I kemi dy ndeshje që janë sikur dy finale. Turqia është ekip me mbrojtje shumë të fortë, por ne

jemi duke i bërë të gjitha planifikimet e duhura që ndaj saj të arrijmë rezultat pozitiv. Synimi ynë është të kalojmë në Ligën B. Turqia mbrohet shumë mirë dhe kundërsulmon shpejt, prandaj do të marrim masa që ta kemi lojën nën kontroll dhe ta menaxhojmë si ndeshjen e parë ashtu edhe të dytën. Do të mundohemi të mbrohem mirë, por edhe të sulmojmë në mënyrë efektive”, ka thënë ai. Sermahaj ka konfirmuar edhe mungesa në grup, mes tyre Genta Feta nga ShBA-ja, e cila, për shkak të angazhimeve me klubin, nuk ka mundur të udhëtojë, derisa ka pohuar se disa prej futbollisteve do t'i bashkohen ekipit nesër. Edhe futbollistet janë të vetëdijshme për rëndësinë e



këtyre përballjeve. Donjeta Halilaj ka theksuar se ekipi është në formë të mirë. “Mendoj se forma ime është 100 për qind, sepse vij nga kampionati aktiv ashtu siç vijnë edhe vajzat e tjera. Jemi në formë të mirë, jemi një grup

kompakt që luajmë bashkë prej kohësh dhe do ta japim maksimumin. Këto janë dy ndeshje shumë të rëndësishme, prandaj u bëj thirrje edhe dardanëve të vijnë, sepse për kraja e tyre është shumë me

vlerë në ndeshje si këto”, ka thënë Halilaj. Ndërsa Lumbardha Misini ka thënë se motivimi dhe përgatitja janë në nivel të lartë. “Si unë edhe vajzat e tjera e kemi ditur rëndësinë e këtyre ndeshjeve dhe jemi munduar ta mbajmë performancën tonë në nivel të lartë. Besoj se secila prej nesh është më e përgatitur se kurrë dhe jemi gati për këto dy ndeshje. Besoj dhe shpresoj që do ta mposhtim Turqinë, sepse ky është synimi ynë dhe për këtë jemi mbledhur. E gjithë ekipi është në gjendje të mirë fizike dhe besoj se gjithçka do të shkojë mirë”, ka thënë Misini, e cila i ka ftuar tifozët “Dardanët” të jenë sa më shumë në stadiumin “Fadil Vokrri”.

RONALDO E DËSHIRON YLLIN E BARCELONËS TEK AL NASSRI



RIAD, 21 TETOR - Robert Lewandowski po përballlet me një sezon vendimtar te FC Barcelona, ku roli i tij është bërë temë diskutimi nën filozofinë e re të vendosur nga Hansi Flick. Sulmuesi polak, i cili ishte një nga figurat kyçe në projektin e Barcelonës sezonin e kaluar, ka parë ndikimin e tij të zvogëlohet për shkak të ndryshimeve taktike dhe fokusit të ekipit drejt një sulmi më lëvizës. Tani vëmendja është zhvendosur në anën tjetër të botës. Klubi saudit Al Nassr mund të jetë duke punuar për ta transferuar atë me kërkesë të Cristiano Ronaldos. Lewandowski po përballlet me një dilemë profesionale: të qëndrojë në Barcelonë apo të nisë një aventurë të re në Ligën Saudite. Al

Nassr, me Cristiano Ronaldon si figurë të padiskutueshme, synon ta forcojë sulmin me një golashënues elitare, duke besuar se Lewandowski është profili i duhur. Operacioni mbështetet në kërkimin për ndikim sportiv dhe imazh për klubin arab, i cili ka tërhequr edhe emra të mëdhenj të tjerë në radhët e tij. Në këtë kontekst, sulmuesi veteran polak shihet si një pjesë kyçe për ta ngritur projektin e Al Nassrit në një nivel të ri konkurrues. Cristiano Ronaldo tashmë ka ushtruar ndikim të drejtpërdrejtë në tregun e transferimeve të Al Nassrit dhe ka kërkuar afrimin e një sulmuesi të afirmuar. Në këtë kuadër, Lewandowski del si kandidati perfekt: aftësi për të shënuar, përvojë ndërkombëtare dhe prani

e fortë mediatike. Prania e ish-bashkëlojtarit të tij te Barcelona, Inigo Martinez, i cili tani është tek Al Nassr, mund ta lehtësojë përshtatjen e tij në Arabinë Saudite. Klubi saudit synon të vazhdojë të tërheqë figura të njohura përtej Ronaldos, duke forcuar ambicien për t'u bërë një pretendues global. Operacioni do të përfshinte një transferim në verë dhe një gatishmëri të Barcelonës për ta shqyrtuar largimin e tij nëse paraqitet një ofertë e përshtatshme. Lewandowski kishte refuzuar një ofertë të majme nga Arabia Saudite verën e kaluar, por tani rrethanat janë ndryshe. Dëshira e lojtarit për të përjetuar një sfidë të fundit të madhe dhe ndikimi i Ronaldos mund ta ndryshojnë situatën.

Bayerni rinovon kontratën me trajnerin Kompany

Bayern, 21 tetor - Trajneri Vincent Kompany e ka rinovuar kontratën edhe për dy vjet me Bayern Munchenin, ka njoftuar ekipi gjerman të martën. Me rinovimin e kontratës, Kompany do të jetë në krye të Bayernit deri

në qershorin e vitit 2029. Kompany ka marrë drejtimin e Bayernit vitin e kaluar dhe në sezonin e tij të parë në Gjermani, e ka fituar titullin e kampionit të Bundesligës. 39-vjeçari është shprehur tejet i

lumtur dhe i nderuar që ka vazhduar kontratën me skuadrën bavareze. Ai, gjithashtu, i ka falënderuar drejtuesit e klubit për besimin e dhënë si dhe ka shtuar se synimi i tij është që edhe këtë sezon ta

mbyll me trofe. Drejtuesit e Bayernit, gjithashtu, janë ndarë të kënaqur me punën dhe rezultatet e deritashme të trajnerit belg, arsyë këto për t'ia rinovuar kontratën që i skadonte në vitin 2027.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “1AR Clothing” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812294817 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "IAR Clothing" D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812294817 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “LAR Clothing” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812294817 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Irfan Hodaj shpall te pa vlefshme dëftesën e shkollës fillore “Luigj Gurakuqi” në Nashec.
- Blerim Gashi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Profesionale Teknike “Gani Qfderbasha” Prizren.
- Samile Mullaibrahimi shpall të pavlefshme diplomën e sh.m të mjekësisë “Hysni Zajmi”.
- Muharrem Shala shpall të pavlefshme diplomën si dhe dëftesat e shkollës fillore “Mustafa Bakija”.
- Albatros Manxhuka shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme “Gjon Nikoll Kazazi”.
- Shqiprim Morina shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme “12 Maji”.
- “Fire Protection Agency Rifiel Action” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.
- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.
- Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.
- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.
- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13. si dhe Diplomën e sh.m. Prof. “Gjon Nikolle Kazazi” Teknologji Informative Gjakove.
- NNSH “Meridian”, shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

